

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ndalohet mishi brazilian, zv.ministrja e bujqësisë; Forcojmë kontrollet në pikat kufi tare! Rrezik për shtrenjtim tëm; mishit? Kika: Prioritet siguria ushqimore
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/ndalohet-mishi-brazilian-zvministrja-e-bujqesise-forcojm-e-kontrollet-ne-pik-i584103
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	5 shtator 2026, 12:04:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	5 shtator 2026, 13:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0d460411fd18119da82820c2158df33b5099e35b287f76e55bfa0d279e6b07fd
TEKSTI	f6b95dab4f33ccd4d11bf4b75cca43fc7e08fc6ba8a701c8756cb616c36328e9
PAMJA	3c7c42b12746faac72254361239d5a12ee4655e0a8475939dda7931469ec92e2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2224efc38bdea84c3252b39aa06188a85d453e993c36ca6ce09f49b26fbed357
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	82597d84b51b00d12dc8da6bd19ef563dde476bcf2b8ac3fbaec8c83c315f326
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 46991200
TRANSAKSIONI	0x4a6949f734bb917e86ef48a394a39f5e560c6ca7cb50992564901c0d93c74ab3
IPFS	QmcQ2vpHEy67KT56kkLrEBokuUFGqg7MP3SJ63znFCszpz



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2224efc38bdea84c3252b39aa06188a85d453e993c36ca6ce09f49b26fbed357>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie [Blokada e natës dhe sanksionet, ambasada amerikane leshon alarm shendetesor per KubenRama nga Italia: Integrimi gradual, e vetmja menyre per te hyre ne BE! S'ne fundit](#)

Ndalohet mishi brazilian, zv.ministrja e bujqësisë: Forcojmë kontrollet në pikat kufitare! Rrezik për shtrenjtim të mishit? Kika: Prioritet siguria ushqimore



5 Shtator 2026, 15:15Bota TEMA



Shqipëria nuk blen më mish nga Brazili. Vendimi i hyrë në fuqi më 3 shtator, ndalon bërjen e porosive për import tek shteti që aktualisht është furnizuesi kryesor global me produkte mishi.

Ministria e Bujqësisë ka sqaruar se do të zbatojnë rregullat e BE-së, të cilat ndalojnë importet e mishit nga Brazili, për shkak të dështimit të ofrimit të garancive të sigurisë për përdorimin e antibiotikëve.

“Shqipëria ka ndjekur rekomandimin dhe rregulloren e re të Bashkimit Evropian në lidhje me pezullimin e importit të mishit të gjedhit dhe shpendëve nga shteti i Brazilit”, deklaroi Kika.

Zëvendësministria e Bujqësisë, Tana Kika, thotë për Report TV se ndalimi nuk prek ngarkesat e certifikuara përpara datës 3 shtator.

“Çdo ngarkesë e certifikuar përpara datës 3 shtator, pavarësisht kohës së mbërritjes në destinacion, është e lejuar të importohet dhe të futet në Republikën e Shqipërisë”, tha ajo.

Ministria e Bujqësisë paralajmëron kontrolle më të forta në pikat e inspektimit kufitar, për të mos lejuar që produktet e mishit nga Brazili të futen në vend.

“Mbas këtij pezullimi në pikat e inspektimit kufitar do të ushtrohen kontrolle edhe më rigorozë në lidhje me garantimin e vendor origjinës dhe në lidhje gjithashtu me garantimin e certifikatës veterinare e cila është unike, pra njëherë përdoret për çdo ngarkesë, e cila daton përpara datës 3 shtator 2026”, thotë Kika.

Përballë rrezikut që konsumatorët shqiptar mund të përballen me çmime më të larta për shkak të boshllëkut që mund të krijohet në treg nga mungesa e mishit brazilian, ministria e Bujqësisë thotë se ka zgjedhur me prioritet sigurinë ushqimore.

“Brazili është një eksportues me potencial shumë të lartë në rang global por garantimi i sigurisë ushqimore mbrojtjes së konsumatorit është prioritet i Ministrisë së Bujqësisë, i qeverisë shqiptare. Në lidhje me rrezikun e shtrenjimit apo mungesës në treg, do të kemi një zëvendësim gradual të produkteve të shtetit nga shteti i Brazil të tjera të tjera të treta të cilat plotësojnë garancitë e kërkesave të Komisionit Evropian”, thotë zëvendësministria.

Në më shumë se 20 vite që vendi importon mish nga Brazili ka pasur disa raste të bllokimit të këtij produkti për shkak të prezencës së lartë me salmonelë, rasti i fundit ishte në 2025-ën.

“Mund të ketë pasur dhe situata të mosgarantimit të sigurisë ushqimore, por janë marrë të gjitha masat për moslejimin e futjes në Republikën e Shqipërisë”, thotë Kika.
Vetëm në gjysmën e parë të këtij viti vendi ka importuar nga Brazili 7,991 tonë “Mish dhe të brendshmet të tij”, me vlerë 1.48 miliardë lekë ose afro 16 milionë euro. Brazili mbulon gati 35% të totalit të importeve që vendi bën për produktet e mishit.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Blokada e naftës dhe sanksionet, ambasada amerikane lëshon alarm shëndetësor për Kubën

13:55 Bota

A mund ta zgjidhë një kujdestar i BE-së bllokimin e gjatë mbi asetet ruse?

12:45 Bota

[Raketa amerikane godet cisternën iraniane pranë Khargut, rriten tensionet në Gjirin Persik](#)

11:55 Bota

[Rama e përgëzoi për rekordin e jetëgjatësisë, Meloni mesazh kryeministrit: Miku im, krenare për rrugëtimin tonë drejt BE](#)

11:05 Bota / 5 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.